



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr.73

Prishtinë, më 19.12.2016, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Salih Morina, nënkryetar, Bekim Haxhiu, Ismajl Kurteshi Shpejtim Bulliqi, Teuta Haxhiu, Mufera Shinik, Shukrije Bytyqi.

Munguan: Nait Hasani dhe Sërgjan Popoviq.

Përfaqësues të ftuar: Ministri i Diasporës dhe ministri për Kulturë, Rini dhe Sport si dhe Mediat dhe përfaqësues të KDI-së

Stafi Mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi Salih Morina, nënkryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të datës 5.12.2016;**
- 3. Diskutimi lidhur me Projekt Buxhetin e MKRS-së dhe Ministrisë së Diasporës për vitin 2017;**
- 4. Të ndryshme.**

Nënkryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i Procesverbalit të datës: 5.12.2016

Procesverbali nga mbledhja e mbajtur më datë 5.12.2016 u miratua pa vërejtje.

3. Diskutimi lidhur me Projekt Buxhetin e MKRS-së dhe Ministrisë së Diasporës për vitin 2017

Në fillim të diskutimit për Projekt Buxhetin e Ministrisë së Diasporës për vitin 2017, anëtarët e Komisionit kërkuan shpjegim shtesë lidhur me mundësitë e realizimit të projekteve të parapara me këtë Buxhet si dhe nevojën e bashkërendimit të aktiviteteve ndërmjet Komisionit dhe Ministrisë.

Në fjalën e tij, ministri Valon Murati, buxhetin aktual të Ministrisë e vlerësoi më shumë si buxhet të mbijetesës, i cili mundëson realizimin e disa aktiviteteve bazike, dërgimin e teksteve në gjuhën shqipe, organizim të seminareve, të ekskursioneve, mbajtjen e kampeve dhe shkollave verore, olimpiadave si dhe aktivitete të natyrës së ngjashme. Sipas tij, ky buxhet nuk mundëson realizimin e obligimeve që dalin nga marrëveshja që kanë mes tyre Republika e Kosovës dhe ajo e Shqipërisë. Ai shtoi se është bërë një hap para në zbatimin e kësaj marrëveshjeje, duke unifikuar kurrikulet si dhe hartimin e dokumentit për standarde të përbashkëta. Kjo pritet të ndodh pas nënshkrimit të marrëveshjes mes dy kryeministrave, marrëveshje e cila duhet të ratifikohet në Kuvend dhe kjo marrëveshje duhet patjetër të përfshijë edhe elementin financiar brenda saj.

Murati, më tej theksoi se për të vendosur në binarë të duhur çështjen e mësimit shqip në diasporë, duhet një buxhet më i madh. Ai ngriti edhe çështjen e thellimit të bashkëpunimit me Komisionin dhe kërkoi mbështetjen e tyre në këtë aspekt. Buxheti shtesë i paraparë për dy shtetet për këtë fushë arrin shumën e 3 milion eurove. Në këtë projekt përfshihen shumë elemente, siç janë: tekstet e reja, fushatë tek diaspora, përkatësisht tek prindërit, institucionalizimi i mësimi, si dhe pagesa e mësuesve ku nuk paguhen nga shtetet përkatëse.

Murati edhe njëherë e vlerësoi si shumë të rëndësishme mbështetjen e Komisionit, ku theksoi edhe nevojën për sensibilizimin për mësimin shqip, vizitat e përbashkëta, takimin me prindër në mënyrë që të rritet numri e nxënësve në shkollat shqipe.

Teuta Haxhiu tha se dallimet e buxhetit ndër vite për këtë Ministri janë shqetësuese dhe si rrjedhojë e kësaj deshi të dijë nëse zyrtarët e Ministrisë së Diasporës janë konsultuar më zyrtarët e Ministrisë së Financave. Ajo shtoi se me këtë buxhet, nuk po vlerësohet roli dhe kontributi i diasporës, madje në këtë mënyrë ata vetëm se po injorohen.

Më tej, ajo foli rreth rekomandimeve të dala nga Auditori për Buxhet në Ministrinë e Diasporës, sa i përket lidhjes së marrëveshjeve duke anashkaluar procedurat e Prokurimit si dhe pagesave në avans.

Një çështje tjetër e ngritur ishte lidhur me marrëveshjet pa zhvilluar procedurë të hapur dhe si rrjedhojë e kësaj uljet konkurrenca dhe paraqitet rreziku që organizatat të mos përfitojnë vlerën për parat e dhëna.

Shpejtim Bulliqi, tha se nga viti 2014 e deri më tash vërehen oscilime të mëdha në aspektin e ndarjes buxhetore sa i përket kësaj Ministrie. Ai tha se është e qartë se buxheti i ndarë për Ministrinë e Diasporës nuk është i mjaftueshëm, por që sipas tij, ata kanë bërë më të mirën e mundshme.

Ai vuri theksin tek analiza e kategorisë së katërt të paraqitur në projekt buxhet, ku shtoi se është për brengosje kur në njërën anë kemi ulje të buxhetit të përgjithshëm kurse në anën tjetër kemi rritje të numrit të të punësuarve.

Një çështje tjetër e ngritur pati të bënte me kurrikulet e përbashkëta me Shqipërinë, ku kërkoi nga përfaqësuesit e Ministrisë së Diasporës që ajo të analizohet më mirë sepse ende ka vend për përmirësim dhe se ne nuk kemi arritur nivelin e njëjtë me Shqipërinë.

Ismajl Kurteshi, vuri theksin tek Marrëveshja mes Kosovës dhe Shqipërisë si dhe tek pjesa ku është paraparë dhjetëfishimi i buxhetit në investimin e shkollimit të fëmijëve tanë në diasporë. Ai shtroi pyetjen se a do të rritet numri i nxënësve në këtë projekt apo do të rritet vëllimi dhe cilësia e shërbimeve?

Mufera Shinik pyeti përfaqësuesit e Ministrisë se si e kanë planifikuar mësimin për komunitetet tjera që jetojnë në Kosovë, që punojnë me kurrikulet e Kosovës.

Bekim Haxhiu, tha se do të duhej që të kishte një bashkëpunim më të madh mes Komisionit dhe Ministrisë dhe se do të kishte qenë e udhës që disa vizita tek bashkatdhetarët tanë të bashkë organizoheshin në mënyrë që të shohim edhe ne si Komision nga afër çështjet dhe problemet e tyre. Ai tha se nëse vazhdohet me këtë qasje ndaj diasporës, nuk do të kemi sukses, duke kërkuar një qasje tjetër sepse diaspora nuk është më sikur ajo e viteve para '90-ta. Sipas tij, ata janë më të arsimuar, më të integruar etj. Një formë bashkëpunimi që duhet të thellohet është përmes Atasheve Kulturore, si dhe mundësimi i mësimin përmes formës online, qendrave kulturore si dhe formave tjera.

Salih Morina, tha se ky diskutim është një mundësi e mirë që të shohim mundësitë që mund të bëjmë në lidhje me buxhetin për Ministrinë e diasporës. Ai po ashtu, tha se janë të interesuar që bashkëpunimi të jetë më i afërt dhe se është mirë që ndonjë anëtarë i Komisionit të jetë pjesë e vizitave.

Morina pyeti se a ka paraparë Ministria buxhet për qendrat kulturore në diasporë.

Ministri Valon Murati, në përgjigjet e tij tha se për të rumbullakuar çështjen e buxhetit, ai është shumë i vogël për realizimin e të gjitha objektivave, sidomos atij të mësimin në shqip, por që betejën për buxhetin e kemi lënë pas marrëveshjes mes dy kryeministrave.

Sa i përket oscilimeve, kjo ka të bëjë me një proces tjetër, atë të regjistrimit të diasporës, proces i cili ka pas të ndarë një buxhet dhe gjatë vitit 2014, kur ka pasur ngecje në formimin e Qeverisë, ky buxhet nuk ka mundur të realizohet në masën e duhur dhe në fund të vitit këto para në shumicën e tyre i janë marrë Ministrisë dhe nuk iu janë kthyer. Si rrjedhojë e kësaj, kjo ka ndikuar në këtë oscilim dhe në cilësinë dhe mundësitë tona për të operuar me buxhetin për çështjen e regjistrimit të diasporës. Në rishikim Buxheti, janë shtuar 200 mijë euro dhe natyrisht kjo ndikon në buxhetin përfundimtar.

Sa i përket të gjeturave të Auditorit, janë çështjet e pagesave jashtë vendit ku për të kryer aktivitetin në një vend, kërkohen mjete në avans dhe të gjeturat e Auditorit janë të kësaj natyre. Ai shtoi se janë të përkushtuar për realizimin e mësimit online dhe se do të ketë pilot projekte në Zvicër ose në Landin e Nord Vesfalen në Gjermani, aty ku shteti paguan për mësimin në gjuhën amtare.

Në lidhje me pyetjen e Kurteshit, sa i përket cilësisë dhe volumit, ministri Murati tha se do të kihet parasysh të dy komponentët. Duhet të jemi të angazhuar në përzgjedhjen e mësuesve të kualifikuar sepse tash një numër i tyre kanë arritur moshën e pensionimit dhe se gjeneratat e reja nuk e kanë përgatitjen adekuate për t'i zëvendësuar ata.

Në përgjigjen e pyetjes për së Mufera Shinik, Murati tha se kjo marrëveshje është paraparë vetëm për mësimin shqip, por që është gjithëpërfshirës edhe për ato komunitete që flasin shqip.

Diskutimi lidhur me Projekt Buxhetin e MKRS-së

Diskutimi në Komision vazhdoi me përfaqësuesit e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit të kryesuar nga ministri Kujtim Shala.

Salih Morina në hapje të diskutimit tha së qëllimi i takimit është që të shohim bashkërisht se çka mund të bëjmë në mënyrë që të realizohen projektet e përfshira në projekt buxhetin e MKRS-së. Ai tha se buxheti i sivjetmë është për 45% më i madh, i cili kryesisht është paraparë të shpenzohet në investime kapitale dhe rritje të subvencioneve. Ai shtoi se Komisionit i intereson të dijë sa a janë hartuar mirë këto projekte dhe tutje buxhetin e paraparë për rininë, të cilin e vlerësoi si buxhet të pamjaftueshëm, karshi nevojave që sektori i rinisë ka.

Ministri Kujtim Shala në fjalën e tij theksoi se rritja e konsiderueshme e buxhetit të Ministrisë që ai drejton vjen si pasojë e shtimit të punëve dhe efikasitetit të tyre, ku sipas raportit të Auditorit për vitin 2015, 98% e buxhetit është realizuar dhe tha se pret që raporti të nxjerr përqindje të përafërt edhe për këtë vit. Rritje të buxhetit është kërkuar për fushën e kulturës dhe të trashëgimisë kulturore, për dy arsye; e para, meqë ka një përparim në fushat specifike, siç është kinematografia dhe te fusha e trashëgimisë janë përfshirë edhe programe të reja.

Sa i përket shpërndarjes së subvencioneve, Shala tha se kjo realizohet në bazë të rregullores për subvencione që përfshin të gjitha fushat e këtij dikasteri. Në vazhdim të elaboratit të tij, Shala tha

se me vendim të Zyrës së Kryeministrit, Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës do të kalojë nën tutelën e Ministrisë. Sa i përket subvencioneve për fushën e rinisë, Shala u pajtua që mund të bëhet më shumë sepse siç tha ai, është i vetëdijshëm që buxheti i ndarë për këtë sektor është i vogël dhe u shpreh i gatshëm që të angazhohen të gjejnë forma për buxhet më të madh për rininë. Ai tha se janë përfunduar dy projekte të mëdha që kanë të bëjnë me rininë, projekti me GIZ-in dhe Bankën Botërore dhe shtoi se tani janë duke punuar me Bankën Botërore për një projekt të ri shuma e të cilit arrin mbi 7 milion euro.

Shala e njoftoi Komisionin se buxheti për shpenzime kapitale dhe subvencione arrin shifrën rreth 30 milionë euro dhe kjo mundëson realizimin e projekteve nacionale, siç janë stadiumi kombëtar , Teatri i Operës dhe Baletit, Muzeu i Arteve Bashkëkohore dhe Muzeu i Historisë - Natyrës. Më tutje Shala tha se ky Buxhet do të mundësojë kryerjen e projekteve aktuale, siç janë qendrat rinore, qendrat e kulturës, rrjetin e palestrave, etj.

Teuta Haxhiu, tha se është shqetësuese ulja e buxhetit për rininë, ndërsa ka rritje të numrit të të punësuarve. Ajo shtoi se janë duke punuar për ndryshimin e Ligjit për rininë në mënyrë që ai të jetë sa më i afërt me nevojat që ka ky sektor dhe kritikoi Ministrinë për buxhetin e ndarë për të. Në vazhdim. Haxhiu tha se disa prej pasojave të buxhetit të vogël për rininë, vërehen në mangësitë e funksionimit të qendrave rinore. Mes tjerash, ajo vlerësoi punën e Ministrisë në fushën e sportit, por që theksoi se shqetësimi kryesor në nivelin lokal janë qendrat kulturore të cilat nuk funksionojnë siç duhet. Ajo shprehu gatishmërinë për bashkëpunim me qëllim që të realizohen interesat e të gjitha artereve që përfaqëson kjo ministri.

Ismajl Kurteshi, vuri theksin tek të gjeturat e auditorit, me ç'rast në gjashtëmujorin e parë të këtij viti, tek kategoria për paga dhe mëditje, buxheti është realizuar për 49%, për mallra dhe shërbime, mbi 50%, për subvencione, buxheti i realizuar arrin 50%, ndërkaq për investimet kapitale janë shpenzuar vetëm 19% të buxhetit të paraparë, fushë në të cilën ju do të duhej të ishit më aktiv.

Shqetësim tjetër i ngritur ishte se projektet kapitale nuk po respektojnë afatet dhe mungon mbikëqyrja e punëve dhe si rrjedhojë e kësaj pastaj kualiteti i punëve është i dobët. Kurteshi tha se një çështje tjetër që po përcillet vit pas viti, është çështja e teatrove, ku ka mungesë të projekteve nga të cilat janë të varura edhe të ardhurat e aktorëve dhe tha se Ministria duhet të angazhohet në mbështetje të kësaj fushe.

Çështje tjetër e ngritur kishte të bënte me kërkesën e disa sportistëve, të cilët kanë sugjeruar që mjetet e ndara për renovimin e stadiumit të qytetit të Gjilanit, nuk do të duhej të realizoheshin për renovim, pasi që ai stadium është rinovuar disa here dhe gjendja e tij nuk është përmirësuar. Kurteshi paraqiti kërkesën e tyre, e cila sugjeron që mjetet e planifikuara për investim renovimi t'iu shtohet edhe një shumë tjetër dhe të ndërtohet një stadium i ri dhe në këtë mënyrë të plotësohen nevojat e katër komunave të rajonit të Ana Moravës.

Shukrije Bytyçi, tha se duhet që puna vullnetare e të rinjve të njihet si përvojë pune. Një problem i paraqitur nga Bytyçi ishte ai i rrjetëzimit të fushave sportive në shkollat fillore dhe ato të mesme, duke theksuar se kjo do të mundësonte që talentet të vihen në pah më lehtë dhe puna me ta do të ishte shumë më e lehtë. Ajo shtoi se duhet të ndahen më shumë mjete për Drejtorinë Komunale për Kulturë, në mënyrë që Shtëpitë e Kulturës të jenë aktive dhe në shërbim të të gjithëve. Shqetësimet e fundit të paraqitura nga Bytyçi ishin të gjeturat e Auditorit sa i përket investimeve kapitale dhe realizimi i projekteve.

Bekim Haxhiu, tha se pavarësisht bashkëpunimit, rezultatet nuk janë të kënaqshme, posaçërisht në detyrat dhe obligimet që ua jep Kuvendi. Haxhiu edhe njëherë foli për çështjen e Memorialit për Lagjen e Jasharajve, për të cilin tha se nuk është përfshirë fare në Projekt Buxhetin për vitin 2017 dhe deshi të dijë se cila është arsyeja e mospërfshirjes. Haxhiu tha se pavarësisht plotësim ndryshimit të Buxhetit të vitit 2016, ku janë ndarë mbi 1 milion euro për renovimin e Stadiumit Olimpik “Adem Jashari”, ato mjete nuk janë investuar. Ai kritikoi Ministrinë për ulje të shumës së paraparë për investim në stadium, duke e cilësuar si të pamjaftueshëm për nevojat që ka stadiumi dhe tha se sipas këtij projekt buxheti, renovimi është shtyrë për vitin 2019.

Haxhiu shtoi se edhe shuma prej mbi 1 milion euro nuk mjafton që stadiumi olimpik të arrijë të jetë sipas standardeve të kategorisë së 4-të, dhe në këtë mënyrë Kosova të mund t’i zhvillojë ndeshjet e saj në këtë stadium. Krejt në fund tha se nëse nuk merren parasysh këto nevoja për përmirësime mes dy leximeve, vota e tij do të jetë kundër për buxhetin e kësaj Ministrie.

Ministri Shala, në përmbledhjen e tij theksoi se është e vërtetë që rinia nuk ka buxhet të mjaftueshëm, por tha se ka ende hapësirë për ndryshim dhe u shpreh i gatshëm që të kontribuojë për këtë. Sa i përket qendrave rinore, Shala tha se janë duke ndërtuar në secilin qytet së paku nga një qendër rinore, duke kryer investimet infrastrukturore dhe pastaj me menaxhimin dhe administrimin e tyre merren komunat përkatëse. Ai tha se njëjtë është edhe me Qendrat e Kulturës, ku Ministria kryen vetëm pjesën infrastrukturore.

Në përgjigjen për pyetjet e Ismajl Kurteshit, Shala tha se vërejtjet e Auditorit janë të sakta, duke shtuar se të gjitha investimet kapitale kryhen së bashku me komunat, në bazë të memorandumeve që ato kanë mes tyre dhe se 80% të investimeve që kryhen, përqindjen më të madhe të procedurave i kryejnë komunat. Ai shtoi se projektet e mëdha, siç është Teatri i Operës dhe Baletit, Muzeu i Historisë-Natyrës kanë ngecur në realizim, në mungesë të marrëveshjes me Komunën e Prishtinës, për lokacionin e tyre dhe si rrjedhojë e kësaj Muzeu i Historisë-Natyrës do të ndërtohet afër zonës së Harilaqit në Fushë-Kosovë.

Sa i përket mbikëqyrjes së punimeve, Shala tha se Ministria mbikëqyr të gjitha projektet dhe se ka pasur dy raste kur nuk janë pranuar punimet. Në lidhje me teatrot, Shala tha se Ministria është përgjegjës vetëm për Teatrin Kombëtar, ndërsa teatrot e qyteteve janë përgjegjësi e komunave dhe edhe pse nuk kanë detyrim ligjor, ministria ka ndarë subvencione për repertorë nga 15 mijë euro dhe ai shtoi se është i vetëdijshëm se nuk janë të mjaftueshme.

Sa i përket stadiumit të Gjilanit, Shala tha se ai është një projekt i trashëguar dhe se synimi është që të arrijnë kategorinë e 4-të dhe në të do të investohen rreth 4 milion euro dhe se shuma prej 500 mijë euro është vetëm faza e parë e investimit.

Në përgjigjen ndaj pyetjes, për njohjen e vullnetarizmit si përvojë pune, ai tha se kjo çështje është zgjidhur më një udhëzim administrativ, por që janë pajtuar që bashkërisht të punojnë për plotësimin e Ligjit për rini, ndërsa për objektet sportive nëpër shkolla, ajo është përgjegjësi e Ministrisë së Arsimit.

Ministri Shala e siguroi deputetin Bekim Haxhiu se buxheti për Memorialin në Prekaz nuk ka humbur dhe se ky buxhet është transferuar tek Instituti i Mbrojtjes së Monumenteve, por problemi është se Ministria e Financave i ka shkruar letër që ky buxhet është alokuar tek MKRS-ja në mënyrë të jashtëligjshme dhe se ky buxhet duhet të i kalojë Agjencisë për Mbrojtjen e Memorialeve.

Shala tha se ka ngecje në renovimin e stadiumit olimpik dhe se problemi është tek auditimi që kanë kërkuar për punimet e fazës së parë të punimeve dhe këtu qëndron arsyeja pse kanë ngecur punimet. Pas gjithë këtyre zhvillimeve është vlerësuar se ky stadium nuk i plotëson kriteret e kategorisë së 4-të dhe në këtë mënyrë nuk mund të zhvillohen ndeshje ndërkombëtare të klubeve ndërsa për zhvillimin e ndeshjeve të Kombëtares, Shala tha se nuk mund të zhvillohen sepse nuk lejon UEFA-ja për arsye sigurie.

4. Të ndryshme.

Për këtë pikë të rendit të ditës nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani